

AKT THEMELIMI

DHE

STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"Green Tecnology Import-Export " Sh.p.k

Sot, me 19.02.2025, une themeluesi kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **" sh.p.k.**

Nepermjet ketij akti shprehet vullneti për krijimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në bazë të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare", i ndryshuar dhe ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007, "Për Qendren Kombëtare të Regjistrimit".

Neni 1

Forma e shoqërisë, Emri, Themeluesit

1. Emri i shoqërisë është **" Green Tecnology Import-Export" sh.p.k.** (me poshtë referuar si "Shoqëria").
2. Forma ligjore e shoqërisë do të jetë *shoqëri me përgjegjësi të kufizuar*.
3. Themelues i shoqërisë është :
Z. GIOVANNI GUARINO, shtetas Italian, lindur në CAPUA(CE), ITALI dhe banues në ITALI, me adresë CAPUA(CE) VIA BOSCARIELLO N.6, lindur më 11.02.1970, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Pasaportë me nr. YB6678219.

Neni 2

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtem:

Importi, eksporti, tregtimi me shumicë dhe pakicë i mallrave: pajisje, aparatura dhe materiale mjeksore dhe laboratorike, sisteme dhe impiante spitalore, pajisje, aparatura, makineri, impiante, materiale dhe artikuj për përdorime të ndryshme.

Importi, eksporti, tregtimi me shumicë dhe pakicë i pajisjeve mekanike të çdo lloji, pajisjeve sportive dhe të administrimit.

Importi, eksporti, tregtimi me shumicë dhe pakicë i pajisjeve Hardware, mirëmbajtja e tyre.

Studimin, projektimin, konsulencën, mirëmbajtjen, sipërmarrjen zbatuese dhe/ose jopublike të veprave me karakter shfrytëzimi dhe/ose administrimi publik dhe/ose privat si: ndërtimin e impianteve fotovoltaike, punime civile, punime elektrike etj. Tregtim me shumicë dhe pakicë, import-eksport i materialeve, makinerive, pajisjeve dhe impianteve të ndryshme elektrike, impianteve/panelevë fotovoltaike, elektroshtëpiake, elektronike, sistemeve/impianteve termike, të ftohjes e ngrohjes (kondicionimit), sisteme për mirë menaxhimin e energjisë, sisteme ndriçimi, të telekomunikacionit si dhe impianteve të tjera të ngjashme të destinuara për objekte civile dhe industriale, për sektore të ndryshme. Shitja me shumicë dhe



pakicë brënda dhe jashtë vendit të materialeve të ndryshme elektrike dhe pajisjeve të tyre të të gjitha llojeve të materialeve të tjera industriale, si impiante ndriçimi, impiante të energjisë alternative, impiante të mbrojtjes nga ngarkesat atmosferike, impiante portash, barrierash dhe kontrollit të dedikuar, impiante kundër grabitjes, zjarrit, përmbajtjeve dhe gazrave, impiante videovëzhgimi CCTV dhe speciale, impiante për transmetim të dhënash etj.

Konshulencë dhe çdo aktivitet që lidhet me fushën e energjisë. Import eksport mallra e pajisje të teknologjise në fushën energjjetikës etj, që do të përdoren në ndërtimin, mirëmbajtjen, dhe menaxhimin e centralit me impjante fotovoltaike e forma të tjera të prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme.

Shërbime në fushën e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme duke përfshirë pa u kufizuar qiradhenie, administrim, menaxhim, mirëmbajtje, riparim, ndërmjetësim etj., për vetë shoqëri apo të tretet.

Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të kryejë çdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e saj. Tregtim të artikujve të ndryshëm industrial dhe ofrimi i shërbimeve me këto artikuj.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve gëzon të drejtën të bëjë ndryshime në objektin e veprimtarisë së shoqërisë së këtu dhe të shihet të nevojshme.

Neni 3

Selia e Shoqërisë

Selia e shoqërisë do të jetë në adresën : Njësia Administrative nr 9, Rr. Jordan Misja, Tiranë.

Shoqëria ka të drejtë që me vendimin e Asamblesë së Ortakëve, të mund të hapë degë, zyra, filiale ose përfaqësi të shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj.

Neni 4

Kohezgjatja

Shoqëria do të ketë kohezgjatje të pacaktuar.

Neni 5

Kapitali themeltar, Kontributet, Pjesët e Kapitalit

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) Leke, i ndarë në 1 (një) kuotë, e zotëruar përkatësisht 1 (një) kuotë që përben 100 % të kapitalit nga ortakët dhe themelues i vetëm GIOVANNI GUARINO.

Kuotat e shoqërisë janë lirisht të transferueshme sipas legjislacionit tregtar në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkojnë për ndryshimin e statutit.



Neni 7

Transferimi i Kapitalit

Kuotat e kapitalit te shoqerise e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributiti ne kapitalin e shoqerise;
- b) Shitblerjes;
- c) Trashegimise;
- d) Dhurimit;
- e) Cdo menyre tjeter te percaktuar ne ligj.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, persa nuk parashikohet ndryshe ne kete statut.

Neni 8

Organet vendimmarrese dhe drejtuese

Organi Vendimmarres

Asambleja e Pergjithshme eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise. Ajo eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve te shoqerise per ceshtjet e meposhtme:

- a) Ndryshimet e statutit;
- b) Emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- c) Emerimin e shkarkimin e likujduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur me siper;
- e) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët, perfshire perгатitjen e
- f) pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- h) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- i) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- l) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblesë;
- m) ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 9

Menyra e thirrjes se Asamblese

9.1 Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkresë ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithë ortakëve, jo me vonë se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblesë.

9.2 Kur asambleja e pergjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortakët jane dakord, per te marre vendime, pavarësisht parregullsise.

Neni 10

Kuorumi



1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

1. Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

2. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës për çështje si:

- a) Emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- b) Emerimin e shkarkimin e likujduesve dhe eksperteve kontabel të autorizuar;
- c) përcaktimin e shpërblimeve;
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e
- e) pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; etj.

Neni 12

Administrimi

1. Shoqëria do të administrohet nga 1 (një) Administrator, i cili emrohet nga Asambleja e përgjithshme për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë riemerimi.

2. Administrator I Shoqërisë do të jetë:

- Z. GIOVANNI GUARINO , shtetas Italian, lindur në CAPUA(CE) ITALI dhe banues në ITALI, me adresë CAPUA(CE) VIA BOSCARIELLO N.6 lindur më 11.02.1970, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Pasaportë me nr..3. Administratori i shoqërisë **ka keto kompetenca:**

a) kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqëson shoqërinë tregtare;

c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecures së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryen regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;



- e) raporton përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
4. Administratori mund të autorizojë persona të tjere për të përfaqësuar shoqërinë dhe për të nënshkruar çdo dokument, kërkesë ose aplikim në emër dhe për llogari të shoqërisë.
5. Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e mospermbushjes së detyrimeve të parashikuara nga dispozitat e këtij statuti dhe legjislacioni në fuqi.

Neni 13

Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia

1. Administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal të realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, kryejnë veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Ndaj veprimeve të administratorit Ortaket kanë të drejtë të ngrenë padi për shlyerjen e dëmit, por edhe padi penale.

Neni 14

Viti financiar, llogarite vjetore, eksperti kontabel

1. Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor. **Llogarite vjetore**, inventaret, raportet mbi operacionet e veçanta të hartuara nga administratori miratohen nga Asambleja e Ortakeve.



2. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar. Ne çdo mbyllje, çdo vit financiar administratori ben inventarin dhe llogarine vjetore ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi per kontabilitetin, si dhe hartohet nje raport me shkrim.

3. Eksperti kontabel ka per detyre te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregetare te shoqerise, ate vjetor dhe ate qe ak lidhje me kontrollat periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai ngarkohet per ta kryer nje gje te tille. Ne perfundim te kontrollit ai pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollat periodike te ushtruara, te cilat ka detyrimin tua paraqese ortakeve per shqyrtim dhe miratim.

Neni 15

Prishja dhe likujdimi i shoqerise

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
 - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
 - d) me vendim të gjykatës;
- Administratorët regjistrojnë prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Nëse prishja e shoqërisë bëhet me vendim gjykate, gjykata, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” ia njofton vendimin Qendrës Kombëtare të Regjistrimeve për regjistrim. Kur shoqëria prishet ajo kalon ne likujdim dhe ne kete rast emertimit te shoqerise i shtohet shenimi ”Shoqeri ne likujdim e siper”. Shoqëria dhe gjate procesit te likujdimit vazhdon si person juridik deri ne perfundimin e procesit te likujdimit. Prishja e shoqerise eshte me pasoja ndaj te treteve vetem pas publikimit te prishjes ne regjistrin tregetar.

Per te perfunduar procesin e likujdimit, Asambleja e Ortakeve emeron nje ose disa persona si likujdues te cilet perfaqsojne shoqerine. Likujduesi perpilon bilancin financiar, likujdon tek te tretet detyrimet e shoqerise, shet aktivet e shoqerise dhe ndan tepricat ne dispozicion.

Neni 16

Dispozita te fundit

Shoqëria ka te drejte te punesoje punonjes qe i nevojiten, per te ushruar veprimtarine e saj. Punesimi behet sipas kushteve te percaktuara ne legjislacionin e punes se Republikes se Shqiperise si dhe rregullave te vena ne kontraten e veçante te punesimit, qe lidhet midis punemaresit dhe punedhenesit.

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarreveshje tjeter qe mund te linde midis shoqerise dhe te treteve, kopetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet ne 3(tre) kopje ne gjuhen shqipe dhe nenshkruhet rregullisht nga Ortaku i shoqerise, sot, me 19.02.2025.



ORTAK I VETEM

I

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"GREEN TECNOLOGY IMPORT-EXPORT" sh.p.k

ALBINO BLOKNI

Perktheu nga gjuha shqipe ne ate italiane: Eliverta Barjami

EB